



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gjiçane
Municipal Gjiçan
Gjiçan Belediyesi

DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË

Datë / Date	
PËR/TO:	Kryetarin e Komunës z.Lutfi Haziri
NGA/FROM:	DREJTORI I DGJKP- së Sadudin Berisha
TEMA / SUBJECT:	RAPORTI GJASHTËMUJOR JANAR – QERSHOR / 2016 (gjer me 30.06.2016)

I nderuari z.Kryetar,

Gjatë këtij gjashtëmuji / 2016 në DGJKP janë kryer këto punë dhe aktivitete tjera si në vijim:

1. Janë pranuar : **3075** lëndë- kërkesa të ndryshme, për regjistrime të pronave, hipoteka, masa të perkohshme, barra tatimore, oferta, vlersime , kërkesa per matje etj.
2. Janë kryer: **2796** lëndë,
3. Në procedurë janë : **178** lëndë,
4. Vendimet në shpallje publike janë: **143** lëndë.
5. **Aktvendime në pritje per azhurnim tekstual : 250 lëndë.**

Përveq kërkesave të palëve janë kryer edhe këto punë sipas detyrës zyrtare :

- Janë lëshuar : 6179 Certifikata të pronësise,
- Janë lëshuar: 1391 Certifikata të gjendjes ekonomike,
- Jane lëshuar: 1531 kopje të planit ,
- Përcaktimi i kufijve në dy anët e lumit në Livoq të Poshtëm gjatesi 500m,
- Përcaktimi i kufijve te rruges fsh.Llashtice.
- Parcelim per nevoja shpronesimit- Lumi Mirusha,
- Identifikimi i objekteve publike në terren për rilevim ,

- Parcelim i ngastres kadastrale per vendosjen e trafos – KEDS,
- Pregaditja e lëndëve për Kuvend , Caktimi i lokacionit per QKMF, caktimi i lokacionit per Shtëpinë e Pleqëve dhe Këmbimi i pronës Komunale me pronë private për nevoja të Shkolles sipas PRRU “Dheu i Bardh-2”
- Vendimet Preliminare për shpronësim per shkolle fillore dhe çerdhe të fëmijëve sipas PRRU “Dheu i Barddh-1” ,
- Kërkesa zyrtare ne Arkivin Historik të Qytetit per pajisje me materialin arkivor per shpronësim te pronave në Lagjen “ILIRIA” -Gjilan,
- Kërkesa per Vlersimin e pronave per shpronësim sipas PRRU “ Qarku-1”
- Identifikimi i prones komunale ne lagjen Zabeli i Sahit Ages,
- Bashkim i parcelave Shkolla e Mesme Teknike Gjilan,
- Identifikimi i ngastrave komunale tek Stadioni Ndhimes,
- Përcaktimi i gjendjes faktike “Lagja Arbëria” ,
- Përcaktimi i lokacioneve per trafostacione ne pronen komunale sipas vendimit të Kuvendit Komunal per dhenien ne shfrytezim ,
- Pregaditja e lëndëve për Kuvend , kembimi i prones komunale me pronen private Rruga Qarkore, si dhe dhenia e prones komunale ne shfrytezim per nevoja te Xhamise se Balcit

-Gjatë kësaj periudhe, DGJKP edhe njëherë ka ndërmarrë hapa konkret në sensibilizimin e pronarëve të trojeve në Lagjen “Dardania” , ku me ftesat dhe njoftimet të cilat i janë shpërndarë të gjithë pronarëve derë më derë të njëjtëve i’u është bërë thirrje që t’i rregullojnë çështjet pronësoro-juridike dhe t’i regjistrojnë pronat e veta të cilat ende sot e kësaj dite si pronare e tyre na paraqitet Komuna e Gjilanit. Ky aktivitet ka filluar t’i jep rezultatet e veta konkrete, sepse vetëm për 10 ditë pune në muajin Qershor /2016, është rritur numri i kërkesave për regjistrimin e këtyre pronave.

-Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë ka përfunduar rilevimin e të gjitha objekteve publike në të gjitha zonat kadastrale rurale (35 zona kadastrale). Me këtë rast janë rilevuar këto objekte dhe sipërfaqe tokësore:

1. Bashkësitë lokale	1460 m ² (objekte dhe oborre)
2. Shkollat	78414 m ² (objekte dhe oborre)
3. Ambulancat.....	9281 m ² (objekte dhe oborre)
4. Fusha të sportit.....	8340 m ²
5. Ofiqaria (Zyret e Vendit).....	721 m ²

Sipërfaqja e tërsishme : 98216 m² (09.82.16 ha).

Nga sipërfaqja e tërsishme të cilat shfrytëzohen për nevoja publike në këto zona kadastrale duke u bazuar në Regjistrat Kadastral, statusi juridik i këtyre pronave është si në vijim :

1. Prona private	10621 m ²
2. Prona të N.Sh (AKP-së).....	22338 m ²
3. KBI (Bashkësia Islame).....	1520 m ²
4. Të padefinuara (mungojn shënimet)..	2975 m ²
5. Prona Komunale.....	60762 m ²

Sipërfaqja e tërsishme : 98216 m² (09.82.16 ha).

-Në procedurë të shpronësimit me Vendime Preliminare janë përfshirë 10286 m² sipërfaqe tokësore për nevoja të rrugëve, Shkollës Fillore dhe Çerdhes së Fëmijëve të parapara me Planin Rregullues Urban “ Dheu i Bardh-1” dhe “Qarku-1” ZK- Gjilan. Jemi në pritje të vlersimit të këtyre pronave nga ana e Organit Vlersues, Zyres PVPP në Ministrinë e Financave.

-Gjithashtu në bashkëpunim me Ministrinë e Ambientit dhe Planifikimit Hapsinor jemi në procedurë të pregaditjes së dokumentacionit për iniciimin e procedurave të shpronësimit nga ana e Qeverisë së Republikës për disa prona të Ndërmarrjeve Shoqërore të menaxhuara nga AKP-ja e të cilat janë me interes të përgjithshëm publik si në nivelin qendror e poashtu edhe ate lokal.

-Gjatë kësaj periudhe, në emër të kompenzimit për pronat e shpronësuara për nevoja të projekteve të ndryshme komunale janë paguar gjithsej : 258.851,27 €.